

Testi që po publikojmë, është vetëm njëri nga variantet e zhvilluara në provimin e Kimisë për Maturën Shtetërore 2020.

Të gjitha variantet kanë pyetje të njëjta, por renditja e tyre ndryshon në çdo variant.

Në variantin e dhënë më poshtë alternativat e sakta janë **të theksuara**.

1. Protonet dhe neutronet gjenden në: 1 pikë
- A) nivelet energjetike  
B) nënivelet energjetike  
C) bërthamën e atomit  
D) gjendjet energjetike
2. Në një atom ndodhen: 1 pikë
- A)  $10 p^+, 14 e^-$   
B)  $48 p^+, 46 e^-$   
C)  $32 p^+, 32 e^-$   
D)  $12 p^+, 10 e^-$
3. Shumica e elementeve mund të gjendet në formën e dy ose më shumë izotopeve natyrore, ku secili izotop zë një përqindje të caktuar. Izotopet e një elementi dallohen nga njëri – tjetri nga numri: 1 pikë
- A) i elektroneve  
B) i neutroneve  
C) i protoneve  
D) atomik Z
4. Germa **M** është simboli i nivelit të jashtëm energjetik të një atomi X. Kjo tregon se: 1 pikë
- A) në atomin e këtij elementi ndodhen 20 elektrone,  
B) numri maksimal i elektroneve në të është 35,  
C) në atomin e elementit X ka gjithsej 12 nënivele,  
D) ky nivel mban në maksimum 18 elektrone.
5. Formula elektronike e atomit të kalciumit, Ca ( $Z=20$ ) shkruhet si vijon: 1 pikë
- A)  $1s^2 2s^2 p^5 3s^2 p^4 4s^2$   
B)  $1s^2 2s^2 p^6 3s^2 p^6 4s^1$   
C)  $1s^2 2s^2 p^6 3s^2 p^6 4s^2$   
D)  $1s^2 2s^2 p^6 3s^2 p^6 d^2$
6. Joni  $X^{3+}$  ka formulën e pjeshme të shtresës së jashtme elektronike  $2p^6$ . Numri atomik Z i elementit X është: 1 pikë
- A) 13  
B) 18  
C) 23  
D) 28
7. Në sistemin periodik, metalet alkaline ndodhen në grupin: 1 pikë
- A) IA  
B) IIA  
C) IB  
D) IIB
8. Për të gjitha metalet mund të thuhet: 1 pikë
- A) ndodhen vetëm në grupet A,  
B) përcjellin rrymën elektrike,  
C) treten shumë mirë në ujë,  
D) kanë pika shkrirjeje të ulta.
9. Nga veprimi i oksidit të kalciumit, CaO me ujin,  $H_2O$  përftohet: 1 pikë
- A) CaOH  
B)  $Ca(OH)_2$   
C)  $CaO_2 + H_2$   
D)  $CaH_2 + O_2$

10. Gazet e plogëta i kanë molekulat një atomike, sepse atomet e tyre (përveç atomit të heliumit) kanë në shtresën e jashtme: **1 pikë**
- A) 12 elektrone  
 B) 10 elektrone  
 C) 8 elektrone  
 D) 6 elektrone
11. Nga elementet alkalino –tokësore të mëposhtme, (grupi IIA) më aktiv është: **1 pikë**
- A) Bariumi  
 B) Magnezi  
 C) Beriliumi  
 D) Kalciumi  
 ( $Z_{Ba}=56$ ;  $Z_{Mg}=12$ ;  $Z_{Be}=4$ ;  $Z_{Ca}=20$ )
12. Nga bashkëveprimi i oksidit të magnezit me acidin klorhidrik të holluar përftohet: **1 pikë**
- A)  $Mg^{2+}_{(uj)} + 2Cl^{-}_{(uj)} + H_{2(g)}$   
 B)  $H_2O_{(l)} + MgCl_{2(uj)}$   
 C)  $H^{+}_{(uj)} + MgO_{(ng)} + Cl^{-}_{(uj)}$   
 D)  $MgCl_{2(uj)} + 2H^{+}_{(uj)} + O^{2-}_{(uj)}$
13. Cili nga reaksionet e mëposhtme **nuk** ndodh? **1 pikë**
- A)  $NaCl + F_2$   
 B)  $KI + Br_2$   
 C)  $KBr + I_2$   
 D)  $NaBr + Cl_2$
14. Elementët e një periode të sistemit periodik kanë të njëjtë numrin: **1 pikë**
- A) e protoneve dhe neutroneve,  
 B) e niveleve energjetike,  
 C) e elektroneve valentore,  
 D) e elektroneve dhe protoneve.
15. Renditja e elementeve të mëposhtëm sipas rritjes së rrezes është: **1 pikë**
- A) Na, Mg, Al,  
 B) Mg, Al, Na,  
 C) Al, Mg, Na,  
 D) Na, Al, Mg.  
 ( $Z_{Na}=11$ ;  $Z_{Al}=13$ ,  $Z_{Mg}=12$ )
16. Dimë se vlera e elektronegativitetit të elementeve zvogëlohet kur kalohet nga lartë –poshtë brenda grupit. Bazuar në këtë mund të themi se brenda grupit nga lartë-poshtë: **1 pikë**
- A) rrezja atomike e elementeve rritet,  
 B) potenciali i jonizimit vjen duke u rritur,  
 C) vetitë reduktuese vijnë duke u zvogëluar,  
 D) energjia e afërisë për elektronin rritet.
17. Formula kimike e oksidit që shfaq karakter acid më të theksuar është: **1 pikë**
- A)  $SO_3$   
 B)  $SiO_2$   
 C)  $P_2O_5$   
 D)  $Cl_2O_7$   
 ( $Z_S=16$ ,  $Z_{Si}=14$ ,  $Z_P=15$ ,  $Z_{Cl}=17$ )
18. Lidhje kovalente jopolare realizohet kur bashkëveprojnë: **1 pikë**
- A) 2Na me  $Cl_2$   
 B)  $H_2$  me  $F_2$   
 C) C me  $2Cl_2$   
 D) Cl me Cl  
 ( $EN_{Na}=0,9$ ;  $EN_{Cl}=3,16$ ;  $EN_H=2,1$ ;  $EN_F=4$ ;  $EN_C=2,5$ )

19. Për të formuar molekulën  $N_2$ , dy atomet e azotit ( $Z_N=7$ ) duhet të lidhen me: **1 pikë**

- A) dy lidhje pi dhe një lidhje sigma
- B) tre lidhje njëfishe sigma
- C) tre lidhje njëfishe pi
- D) dy lidhje sigma dhe një lidhje pi

20. Një lidhje sigma dallohet nga një lidhje pi për shkak se: **1 pikë**

- A) zona e mbulimit të orbitalit sigma është anësore,
- B) lidhja sigma është më e dobët se lidhja pi,
- C) gjatë formimit të saj çlirohet më pak energji,
- D) për prishjen e saj duhet më shumë energji.

21. Një molekulë poliatomike që i ka të gjitha lidhjet (midis atomeve përbërëse të saj) kovalente polare mund të jetë polare ose jopolare. Kjo gjë varet nga forma gjeometrike e saj. Formula kimike e molekulës, e cila i ka të gjitha lidhjet kovalente polare dhe gjithashtu është dhe vetë polare, është: **1 pikë**

- A)  $CCl_4$
  - B)  $H_2O$
  - C)  $SiF_4$
  - D)  $CF_4$
- ( $EN_C=2,5$ ;  $EN_{Cl}=3,16$ ;  $EN_F=4$ ;  $EN_O=3,5$ ;  $EN_{Si}=1,9$ ;  $EN_H=2,1$ )

22. Forma gjeometrike e molekulës së amoniakut,  $NH_3$  është: **1 pikë**

- A) trekëndore planare
  - B) piramidë trekendore
  - C) tetraedrike
  - D) katër këndore
- ( $Z_N=7$ ;  $Z_H=1$ )

23. Pika e lartë e vlimit të ujit shpjegohet me faktin se: midis molekulave të ujit, përveç forcave dipol-dipol ekzistojnë dhe forcat e lidhjes: **1 pikë**

- A) hidrogjenore
- B) sigma dhe pi
- C) kovalente jopolare
- D) kovalente polare

24. Molekula, e cila përmban atom qendror që nuk plotëson oktetin elektronik është: **1 pikë**

- A)  $CH_4$
  - B)  $BF_3$
  - C)  $CCl_4$
  - D)  $NH_3$
- ( $Z_C=6$ ,  $Z_B=5$ ;  $Z_N=7$ ;  $Z_H=1$ ;  $Z_{Cl}=17$ ;  $Z_F=9$ )

25. Bazuar në rregullat e IUPAC, emërtim i saktë është: **1 pikë**

- A) metil -3, propan
- B) dimetil -1, 2, etan
- C) buten - 3
- D) dimetil -2, 2- propan

26. 0,1 mol i një alkeni e ka masën 5,6 gram. Formula molekulare e tij është: **1 pikë**

- A)  $C_2H_4$
  - B)  $C_3H_6$
  - C)  $C_4H_8$
  - D)  $C_5H_{10}$
- ( $A_{rC}=12$ ;  $A_{rH}=1$ )

27. Në grupin e alkaneve bën pjesë përbërja, formula molekulare e së cilës është: **1 pikë**

- A)  $C_2H_6$
- B)  $C_5H_{10}$
- C)  $C_4H_8$
- D)  $C_3H_6$

28. Numri i izomerëve të pozicionit që formohen nga buteni, ( $C_4H_8$ ), është: **1 pikë**
- A) 5  
B) 4  
C) 3  
D) 2
29. Formula molekulare e përbërjes, e cila sipas IUPAC emërtohet dimetil -2,3- penten -2, është: **1 pikë**
- A)  $C_7H_{16}$   
B)  $C_5H_{12}(CH_3)_2$   
C)  $C_4H_{10}(CH_3)_2$   
D)  $C_7H_{14}$
30. Numri i mol atomeve squfur, që ndodhen në 68 gram  $H_2S$ , është: **1 pikë**
- A) 1  
B) 2  
C) 3  
D) 4  
(ArS=32; ArH=1)
31. Në një mol-molekula  $H_2$ , ndodhen: **1 pikë**
- A)  $3,01 \times 10^{23}$  molekula  
B)  $6,02 \times 10^{23}$  molekula  
C)  $9,03 \times 10^{23}$  molekula  
D)  $12,04 \times 10^{23}$  molekula
32. Masa në gram e  $6,02 \times 10^{23}$  molekulave  $CO_2$  është: **1 pikë**
- A) 22g  
B) 44g  
C) 66g  
D) 88g  
(ArC = 12, ArO = 16.)
33. Vëllimi që zë në kushte normale 0,1 mol oksigjen, ( $O_2$ ), është: **1 pikë**
- A) 4,48 litra  
B) 3,36 litra  
C) 2,24 litra  
D) 1,12 litra
34. Raporti në masë midis elementeve përbërëse në formulën kimike FeS është: **1 pikë**
- A) 1:1  
B) 3:2  
C) 5:3  
D) 7:4  
(ArFe=56; ArS=32)
35. Masa në gram e klorurit të natriumit që përftohet nga bashkëveprimi i 2,3 g natrium me klor është: **1 pikë**
- A) 0,585g  
B) 5,85g  
C) 58,5g  
D) 585g  
(ArNa=23; ArCl=35,5)
36. Përqindja e pastërtisë së xeherorit të oksidit të aluminit,  $Al_2O_3$ , me masë 500 kg është 85%. Masa e oksidit të aluminit të pastër në këtë xeheror është: **1 pikë**
- A) 425 kg  
B) 400 kg  
C) 375 kg  
D) 350 kg

37. Përqendrimi molar i tretësirës që përmban 40g NaOH në një litër të saj, është: **1 pikë**

- A) 4M
- B) 3M
- C) 2M
- D) **1M**

( $A_{rNa}=23$ ;  $A_{rO}=16$ ;  $A_{rH}=1$ )

38. Nga djegia e 2,3 gram mostër të një përbërjeje organike, e cila përbëhet nga karboni, hidrogjeni dhe oksigjeni u përftuan 4,4 gram dioksid karboni dhe 2,7 gram ujë. Dëndësia e kësaj përbërjeje në krahasim me hidrogjenin është 23. Formula molekulare e kësaj përbërjeje është: **1 pikë**

- A)  **$C_2H_6O$**
- B)  $C_3H_8O$
- C)  $C_4H_{10}O$
- D)  $C_5H_{12}O$

( $A_{rC}=12$ ,  $A_{rH}=1$ ,  $A_{rO}=16$ )

39. Nga substancat e paraqitura më poshtë, veti acide më të theksuara shfaq: **1 pikë**

- A)  **$HClO_4$ , acidi perklorik,**
- B)  $H_2SO_4$ , acidi sulfurik,
- C)  $H_2CO_3$ , acidi karbonik,
- D)  $H_3PO_4$ , acidi fosforik.


40. Përqendrimi i joneve hidrogjen në tretësirën ujore të acidit klorhidrik është 0,1 mol/l. Vlera e pH së kësaj tretësire është: **1 pikë**

- A) 11
- B) 8
- C) 4
- D) **1**

41. Acidi klorhidrik i holluar vepron me një nga metalet e mëposhtme. Simboli i tij është: **1 pikë**

- A) Cu
- B) **Zn**
- C) Ag
- D) Hg

42. Një reaksion që zhvillohet midis tretësirës ujore të një acidi të fortë dhe tretësirës ujore të një baze të fortë, mund të shkruhet në formën jonike të plotë dhe jonike të shkurtuar. Kur shkruhet në formën jonike të plotë, përveç joneve që marrin pjesë në reaksion shkruhen dhe jonet spektatore. Jonet që marrin pjesë në reaksionin:



- A)  **$H^+_{(uj)}$  dhe  $OH^-_{(uj)}$**
- B)  $H^+_{(uj)}$  dhe  $SO_4^{2-}_{(uj)}$
- C)  $Na^+_{(uj)}$  dhe  $SO_4^{2-}_{(uj)}$
- D)  $Na^+_{(uj)}$  dhe  $OH^-_{(uj)}$

**1 pikë**


43. Shpejtësia e reaksionit rritet kur: **1 pikë**

- A) zvogëlohet numri i goditjeve në tërësi,
- B) zmadhohet vëllimi i enës ku ndodhen reaktantët,
- C) **rritet numri i goditjeve të frytshme,**
- D) nuk prishen lidhjet në molekulat e reaktantëve.

44. Barazimi i shpejtësisë për reaksionin midis hidrogjenit dhe jodit:  $H_{2(g)} + I_{2(g)} \rightarrow 2HI_{(g)}$ , në të cilin koeficientët eksperimentalë të reaktantëve janë të barabartë me nga një njësi, shkruhet si vijon: **1 pikë**

- A)  $V = [HI]^2 \cdot [I_2]$
- B)  $V = [H_2] \cdot [I_2] / 2HI$
- C)  $V = K \cdot [H_2] \cdot [HI]^2$
- D)  **$V = K \cdot [H_2] \cdot [I_2]$**

45. Hidrogjeni vepron me oksidin e azotit duke dhënë një gaz më të rëndë se ajri, me aromë pak të ëmbël, që nuk merr flakë në temperaturën e dhomës, që përdoret për anestezi gjatë ndërhyrjeve të vogla kirurgjikale. Ky gaz lirohet në atmosferë si pasojë e aktivitetit industrial dhe ndihmon në ngrohjen globale. Gazi në fjalë është gjetur me shumicë në shtresën e ozonit stratosferik. Ai është oksidi i diazotit me formulën  $N_2O$ , quhet ndryshe gazi gaztor dhe përftohet sipas reaksionit:



Në tabelën e mëposhtme jepen disa të dhëna eksperimentale për këtë reaksion:

$[H_2]$ , mol $L^{-1}$	$[NO]$ , mol $L^{-1}$	Shpejtësia e reaksionit, mol $L^{-1} s^{-1}$
0,10	0,20	$2,04 \times 10^{-2}$
0,10	0,40	$8,16 \times 10^{-2}$
0,20	0,40	$16,32 \times 10^{-2}$

Vlera e konstantes së shpejtësisë së këtij reaksioni është:

1 pikë

- A)  $1,5 \text{ mol}^{-2} \text{ L}^2 \text{ s}^{-1}$   
 B)  $5,1 \text{ mol}^{-2} \text{ L}^2 \text{ s}^{-1}$   
 C)  $6,5 \text{ mol}^2 \text{ L}^2 \text{ s}^{-1}$   
 D)  $5,6 \text{ mol}^{-2} \text{ L}^2 \text{ s}$

46. Në organizmat e gjalla, në mjaft procese industriale dhe në natyrë zhvillohen një sërë reaksionesh kimike, të cilat shoqërohen me çlirim ose thithje energjie. Më poshtë janë paraqitur disa reaksione kimike, disa prej të cilave zhvillohen në industri. Duke


i krahasuar nga pikpamja energjetike, del se reaksion endotermik është:

1 pikë


- A)  $CaCO_{3(ng)} \rightarrow CaO_{(ng)} + CO_{2(g)}$   $\Delta H > 0$   
 B)  $2Hg_{(ng)} + O_{2(g)} \rightarrow 2HgO_{(ng)}$   $\Delta H < 0$   
 C)  $N_{2(g)} + 3H_{2(g)} \rightarrow 2NH_{3(g)}$   $\Delta H < 0$   
 D)  $2NO_{(g)} + O_{2(g)} \rightarrow 2NO_{2(g)}$   $\Delta H < 0$

47. Jepen statet e zhvillimit të reaksionit në  $25^{\circ}C$ :

1 pikë



Reaksioni i përgjithshëm është:



Bazuar në ligjin e Hesit del se vlera e  $\Delta H_1$  në këtë rast është:

- A) + 341,8 kJ  
 B) - 457,2 kJ  
 C) - 341,8 kJ  
 D) + 457,2 KJ

48. Në reaksionin  $2SO_2 + O_2 \leftrightarrow 2SO_3$  ( $\Delta H < 0$ ), kemi arritur në pozicionin e ekuilibrit për një temperaturë të caktuar. Për të zhvendosur ekuilibrin në drejtim të formimit të  $SO_3$ , duhet:

1 pikë

- A) të rritim temperaturën,  
 B) të rritim përqëndrimin e  $SO_3$ ,  
 C) të zvogëlojmë trysninë,  
 D) të rritim përqëndrimin e  $SO_2$

49. Reaksionet e mëposhtme, (secili prej tyre në një temperaturë specifike) ndodhen në gjendjen e ekuilibrit kimik. Ndryshimi i trysnisë ndikon vetëm tek reaksioni:

1 pikë

- A)  $N_{2(g)} + O_{2(g)} \leftrightarrow 2NO_{(g)}$   
 B)  $H_{2(g)} + I_{2(g)} \leftrightarrow 2HI_{(g)}$   
 C)  $N_2O_{4(g)} \leftrightarrow 2NO_{2(g)}$   
 D)  $FeO_{(ng)} + H_{2(g)} \leftrightarrow Fe_{(ng)} + H_2O_{(g)}$

50. Në një enë me vëllim një litër është futur për tu shpërbërë 1 mol jodur hidrogjeni, HI, në temperaturën  $440^{\circ}C$ . Kur arrihet ekuilibri, përqëndrimet e hidrogjenit dhe të jodit të pranishëm në enë janë secili 0,11 mol/l, ndërsa përqëndrimi i jodurit të hidrogjenit

është 0,78 mol/l. Vlera e konstantes së ekuilibrit në reaksionin:  $2HI \leftrightarrow H_2 + I_2$ , është:

1 pikë

- A) 0,0198  
 B) 0,0321  
 C) 0,0454  
 D) 0,0532

51. Sipas teorisë së Bronshted – Lauri, në reaksionin:  $\text{H}_3\text{O}^+ + \text{NH}_3 \leftrightarrow \text{H}_2\text{O} + \text{NH}_4^+$ , mund të themi se: **1 pikë**
- A)  $\text{H}_3\text{O}^+$  është bazë,  
 B)  $\text{NH}_4^+$  është bazë,  
 C)  $\text{NH}_3$  është bazë,  
 D)  $\text{H}_2\text{O}$  është acid
52. Përqendrimi i joneve hidrogjen,  $[\text{H}^+]$ , në tretësirën ujore 0,1 M të një acidi të fortë HX, është: **1 pikë**
- A)  $1 \times 10^{-13}$  mol-jone/l,  
 B)  $1 \times 10^{-9}$  mol-jone/l,  
 C)  $1 \times 10^{-5}$  mol-jone/l,  
 D)  $1 \times 10^{-1}$  mol-jone/l,
53. Për një tretësirë bazike mund të thuhet se: **1 pikë**
- A)  $\text{pH} > 7$   
 B)  $\text{pH} < 7$   
 C)  $\text{pH} = 7$   
 D)  $\text{pH} = 0$
54. Dimë se produkti jonik i ujit (në 298 K) e ka vlerën  $10^{-14} \text{ mol}^2/\text{l}^2$ . Nëse në një tretësirë  $[\text{H}^+] = 10^{-3} \text{ mol-jone/l}$ , atëhere  $[\text{OH}^-]$  do të jetë: **1 pikë**
- A)  $10^{-3}$  mol-jone/l,  
 B)  $10^{-6}$  mol-jone/l,  
 C)  $10^{-9}$  mol-jone/l,  
 D)  $10^{-11}$  mol-jone/l,
55. Në cilën nga përbërjet e mëposhtme, atomi i klorit shfaq numrin e oksidimit +5 **1 pikë**
- A)  $\text{HClO}_4$   
 B)  $\text{HClO}_3$   
 C)  $\text{HClO}_2$   
 D)  $\text{HClO}$
56. Për elementin galvanik  $\text{Zn}_{(\text{ng})} / \text{Zn}^{2+}_{(\text{uj})} // \text{Cu}^{2+}_{(\text{uj})} / \text{Cu}_{(\text{ng})}$  është i saktë pohimi: **1 pikë**
- A) në gjysëm elementin  $\text{Zn}/\text{Zn}^{2+}$  zhvillohet procesi i reduktimit,  
 B) procesi i oksidimit zhvillohet në gjysëm elementin  $\text{Cu}^{2+}/\text{Cu}$ ,  
 C) pllaka e zinkut është më pak aktive se pllaka e bakrit,  
 D) ky element funksionon derisa të tretet pllaka e Zn.  
 $(E^\circ_{\text{Zn}^{2+}(\text{uj}) / \text{Zn}(\text{ng})} = -0,76\text{V} \quad E^\circ_{\text{Cu}^{2+}(\text{uj}) / \text{Cu}(\text{ng})} = +0,34\text{V})$
57. Numrat e oksidimit të elementeve ndryshojnë te reaksioni: **1 pikë**
- A)  $\text{MgO}_{(\text{ng})} + 2\text{HCl}_{(\text{uj})} \rightarrow \text{MgCl}_{2(\text{uj})} + \text{H}_2\text{O}_{(\text{l})}$   
 B)  $\text{Al}_2\text{O}_{3(\text{ng})} + 6\text{NaOH}_{(\text{uj})} \rightarrow 2\text{Na}_3\text{AlO}_{3(\text{uj})} + 3\text{H}_2\text{O}_{(\text{l})}$   
 C)  $\text{MnO}_{2(\text{ng})} + 4\text{HCl}_{(\text{uj})} \rightarrow \text{MnCl}_{2(\text{uj})} + \text{Cl}_{2(\text{g})} + 2\text{H}_2\text{O}_{(\text{l})}$   
 D)  $\text{ZnO}_{(\text{ng})} + \text{H}_2\text{SO}_{4(\text{uj})} \rightarrow \text{ZnSO}_{4(\text{uj})} + \text{H}_2\text{O}_{(\text{l})}$
58. Agjenti oksidues në reaksionin:  $2\text{NaCl} + \text{F}_2 \rightarrow 2\text{NaF} + \text{Cl}_2$ , është: **1 pikë**
- A) atomi i fluorit,  
 B) joni fluorur,  
 C) atomi i klorit,  
 D) joni klorur.
59. Gjatë elektrolizës së  $\text{MgCl}_2$  të shkrirë, në katodën joaktive ndodh reaksioni i reduktimit, i cili është: **1 pikë**
- A)  $\text{Mg}^{2+} + 2\text{e}^- = \text{Mg}^0$   
 B)  $\text{Cl}_2 + 2\text{x}1\text{e}^- = 2\text{Cl}^-$   
 C)  $\text{Mg} - 2\text{e}^- = \text{Mg}^{2+}$   
 D)  $2\text{Cl}^- - 2\text{x}1\text{e}^- = \text{Cl}_2^0$
60. Në reaksionin:  $4\text{NH}_3 + 5\text{O}_2 \rightarrow 6\text{H}_2\text{O} + 4\text{NO}$ , atomi i azotit gjatë kalimit nga  $\text{NH}_3$  në  $\text{NO}$ : **1 pikë**
- A) ka dhënë  $3\text{e}^-$   
 B) ka marrë  $2\text{e}^-$   
 C) ka dhënë  $5\text{e}^-$   
 D) ka marrë  $5\text{e}^-$